

**VENDIM**  
**Nr. 461, datë 26.7.2018**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1058, DATË 22.12.2010, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR KALIMIN E ISH-SHKOLLËS SË ULËT TË NDËRTIMIT (3 KATE)**  
**DHE ISH-KONVIKTIT (4 KATE), SHKOZET, DURRËS, NË PËRGJEGJËSI**  
**ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR**  
**ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, PËR QËLLIM PRIVATIZIMI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 10, 11 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pika 3, e vendimit nr. 1058, datë 22.12.2010, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:  
“3. Procedurat e privatizimit të apartamenteve dhe lidhja e kontratës të bëhen brenda 1 (një) viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Në rast se personi, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi, nuk paraqitet pranë EKB-së të lidhë kontratën brenda afatit 1-vjeçar, familjes i humbet e drejta e privatizimit dhe objekti do të përdoret nga Enti Kombëtar i Banesave, në zbatim të politikave të strehimit, sipas legjislacionit në fuqi.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Enti Kombëtar i Banesave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**